



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALIQ

KONTRATE

E lidhur sot ne date 04.09.2014 ne Bashkine Maliq midis paleve :

AUTORITETIT KONTRAKTOR : Bashkia Maliq perfaqesuar nga Kryetari Z. Gezim Topçiu, i quajtur me poshte Autoriteti Kontraktor (investitor)

KONTRAKTUESI : Operatori Ekonomik "Leka" shpk me NIPT J641036310 perfaqesuar nga , Barjam Leka i quajtur me poshte (sipermares)

Baza Ligjore : Ligji Nr.9643, date 20.11.2006 , "Per prokurimin publik" (i ndryshuar) , V.K.M. Nr.1 , date 10.01.2007 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" (i ndryshuar), Ligji Nr.7850, date 29.07.1994 "Kodi Civil".

NENI 1
Objekti I Kontrates

Objekt i kesaj kontrate eshte : "Rikonstruksion nyje sanitare shkolla e mesme Maliq"

NENI 2
VLERA E KONTRATES

Vlera totale e kontrates eshte :

1.187.050 (njemilion e njegindetetehjeteshtatemije e pesedhjete) leke pa Tvsh

1.424.460 (njemilion e katerqindenjzetekatermije e katerqindegjashtedhjete) leke me Tvsh

NENI 3
AFATI

1. Afati kohor per ekzekutimin e kontrates eshte 1 muaj nga data e lidhjes se kontrates .
2. Per çdo dite vonese pertej dates te percaktuar nga Autoriteti Kontraktor, Sipermaresi detyrohet te paguaje penalitetet ne masen 0.01 % te vleres se kontrates. Kjo vonese do te behet si diference ne situacionin perfundimtar.
3. Kur vonesa e afatit i kalon 10 dite kontrata zgjidhet pa kushte nga Autoriteti Kontraktor.

NENI 4
AFATET E PAGESES

1. Pagesa do te kryhet nga Autoriteti Kontraktor pas perfundimit te punimeve.
2. Pagesa do te kryet ne leke Shqiptare ne llogarime bankare te operatorit "Leka" shpk ne llogarime Nr.551188800001, IBAN AL98 2094 2553 0000 5511 8880 0001.

**NENI 5
DETYRIMET E INVESTITORIT**

1. Lirimini e sheshit të ndërtimit në momentin e lidhjes së kontratës.
2. Investitori në bazë të shtojcës 15, pikës 18.1 dhe 33.5 të DST (Kushtet e përgjithshme të kontratës) mund të shtyjë afatit e përfundimit të punimeve pas kërkesës me shkrim nga sipërmarësi.
3. Të kryejë pagesat sipas situacioneve të paraqitura nga sipërmarësi duke mbajtur të pa ndryshuar çmimet e fitura në tender vetëm atëherë kur janë firmosur nga Drejtuesi i Punimeve.
4. Të ndjehet dhe të sigurojë kontrollin e punimeve nepërmjet Drejtuesit të Punimeve, i cili do të caktohet nga Investitori.

**NENI 6
DETYRIMET E SIPERMARËSIT**

1. Sipërmarësi do të jetë përballë Investitorit teresisht, teknikisht, administrativisht dhe juridikisht përgjegjës për zbatimin e punimeve sipas projektit dhe preventivit bashkëngjitur kësaj kontrate në përputhje të plotë të KTZ dhe të dorezohet objektin brenda afatit të përcaktuar në kontratë.
2. Sipërmarësi nuk mund të ndryshojë zërat e punës të përcaktuara pa pëlqimin e Investitorit dhe Drejtuesit të Punimeve dhe këto me shkrim. Punimet e maskuara do të kryhen në përputhje me KTZ dhe do të shoqërohen me dokumentacionin përkatës të miratuar dhe firmosur nga Drejtuesi i Punimeve.
3. Të riparohet të metat e konstatuara nga Drejtuesi i Punimeve brenda afatit të përcaktuar nga ai të krijojë në dy kopje dosjen e objektit sipas kërkesave të drejtuesit të punimeve.

**NENI 7
SIGURIMI I KONTRATËS**

1. Për sigurimin e kontratës Operatori "Leka" shpk do të depozitojë për llogari të investitorit sigurimin e kontratës në masën 10% të vlerës së kësaj kontrate.
2. Garancia e sigurimit të kontratës do të kthehet sipërmarësit në përfundim të kontratës së lidhur midis paleve.

**NENI 8
ZGJIDHJA E KONTRATËS**

1. Zgjidhja e kësaj kontrate do të bëhet kur ka përfunduar afati i përmendur në nenin 3 pika 1 të kësaj kontrate.

Kontrata zgjidhet dhe në rastet kur :

- Sipërmarësi ndalon punimet për 10 ditë rresht pa arsye dhe nuk parashikohet në programin e punimeve të miratuar dhe kur ndalimi nuk është autorizuar nga Investitori apo Drejtuesi i Punimeve.
- Sipërmarësi falimenton dhe fillon likuidimet, keqepërdor fondet etj

Në këto raste likuidimi i punimeve do të bëhet konform kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

**NENI 9
GARANCIA E DIFEKTEVE**

Periudha e Garancisë së Difeleve do të jetë 12 (dymbëdhjetë) muaj pas përfundimit të punimeve (akt-kolaudit). Shuma e garancisë së mbajtur për efekt të Garancisë së Difeleve do të jetë në masën 5% të

Kontrates dhe do te behet nga situacionet pjesore ne menyre propocionale me vleren e situacionit
te lirohet ne fund te periudhes te Garancise se Difekteve.

NENI 10
ZGJIDHJA E MOSMARREVESHJEVE

1. Palet duhet te bejne çdo perpjekje per te zgjidhur mosmarreveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ne lidhje me kete kontrate.
2. Nese palet deshtojne ne zgjidhjen e mosmarreveshjeve ose konflikteve, secila nga palet mund t'i drejtohet Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korçe per zgjidhjen e mosmarreveshjeve.

NENI 11

Te gjitha dokumentat e tenderit jane pjese perberese e kesaj Kontrate.


Kjo kontrate u hartua ne 4 (kater) kopje duke u firmosur prej paleve ne cdo flete. Nje kopje e kontrates ju dorezua sipermarsit dhe tre kopje ngelen ne Bashkine Maliq.

SIPERMARESI
"Leka" shpk

Perfaqesuar nga
Z. Barjam LEKA



JURIST
Gençi Floqi



INVESTITORI
BASHKIA MALIQ

Perfaqesuar nga:
Kryetari I Bashkise
Z. Gezim TOPÇIU

